



Datë: 2 Shtator 2024

TERMA REFERENCE

SHËRBIMI I KËRKUAR: REALIZIMI I NJË VIDEOJE NDËRGJEGJËSUESE PËR TË RRITUR PËRFSHIRJEN E GRAVE DHE VAJZAVE NË PROCESET VENDIMMARRËSE

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jo-politike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbron të drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë më datë 28/06/2022 me vendimin nr. 1738. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar gjithashtu pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

Misioni i Qendrës është të kontribuojë për krijimin e një shoqërie ku të gjitha gratë të jetojnë një jetë me dinjitet, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta.

Qasja e Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, është:

- Të punojë për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare rreth të drejtave të grave dhe çështjeve gjinore;
- Të mbështesë gratë dhe vajzat për të rritur pjesëmarrjen dhe influencën e tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit nëpërmjet zbatimit të programeve të lidhshme, rritjes së aftësive profesionale, etj.;
- Të adresojë nevojat e grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve direkte me qëllim fuqizimin e tyre social dhe ekonomik;
- Të rrisë kapacitetet e punonjësve të institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore që punojnë për mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për gra dhe vajza;
- Të advokojë dhe llobojë për respektimin e të drejtave të grave dhe arritjen e drejtësisë gjinore në shoqërinë shqiptare;
- Të kryejë studime, analiza dhe kërkime rreth çështjeve gjinore, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

2. INFORMACION MBI SHËRBIMIN E KËRKUAR

Qendra për Drejtësi Gjinore, më 1 Maj 2024, ka filluar zbatimin e projektit: “Monitorimi dhe përmirësimi i zbatimit të buxhetimit dhe politikave gjinore në Bashkinë Elbasan”, me mbështetjen nga skema e granteve “BAT Civil Society”, e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në partneritet me Faktoje dhe Center for Research and Policy Making (CRPM), mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

Në kuadër të projektit, **kërkohet të kontraktohet një kompani / person (video maker) për realizimin e një videoje ndërgjegjësuese për të rritur përfshirjen e grave dhe vajzave në proceset vendimarrëse.**

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Rr. "Nikolla Tupe", P. 352, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; E-mail: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531



PERIUDHA E SHËRBIMIT TË KËRKUAR

Shërbimi do të ofrohet gjatë periudhës 17 – 30 Shtator 2024 dhe do të konsistojë në 4 (katër) ditë pune.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

- Të bashkëpunojë me stafin e QDGJSH për hartimin e skenarit të videos;
- Të jetë përgjegjës për gjetjen e personazheve që do të përfshihen në video;
- Të realizojë videon në cilësinë e kërkuar (në gjuhën shqipe dhe titra në gjuhën angleze);
- T'i përgjigjet kërkesave të QDGJSH për ndryshime dhe rishikime të mundshme të videos;
- Të dorëzojë produktin final pranë QDGJSH në cilësinë dhe afatin e kërkuar;
- Të ketë komunikim korrekt dhe bashkëpunim me stafin e QDGJSH, përgjegjës për zbatimin e projektit;
- Të përgatisë dhe dorëzojë kohëshënuesin për punën e kryer në përfundim të shërbimit të kërkuar.

4. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë universitare në regjizurë apo degë e ngjashme;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme pune në realizimin e videove;
- Të ketë eksperiencë të mëparshme pune me organizata të shoqërisë civile;
- Të zotërojë aftësi shumë të mira komunikuese;
- Të jetë bashkëpunues/e, me qasje pozitive dhe etikë profesionale.

5. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Curriculum Vitae;
- Ofertë financiare për shërbimin e kërkuar në monedhën EUR.

Adresë elektronike: genderjusticealbania@gmail.com; adena.vangjeli@gjalbania.org

Adresë postare: Rr. "Nikolla Tupe", P. 352, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri.

6. AFATET

Afati për dërgimin e aplikimeve: 13/09/2024, ora 17:00

Njoftimi i aplikantëve: 16/09/2024